

Circular Economy in Tourism

CEN TOUR



BULETINI INFORMATIV VËLLIMI. 1 - SHKURT 2021

PROJEKTI

CEN TOUR - Ekonomia Rrethore në Turizëm është projekt i financuar nga programi COSME që zbaton një skemë të ngritjes së kapaciteteve dhe mbështetjes për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme të sektorit të turizmit në pesë vende të Evropës (Itali, Spanjë, Maqedonia e Veriut, Moldavi, Greqia) duke i drejtuar ata për të arritur nivele të ndryshme të inovacioneve të ekonomisë rrethore brenda një perspektive të sistemit në tranzicion, veçanërisht përmes zinxhirit të kundërt të furnizimit dhe simbiozës.

OBJEKTIVAT

CEN TOUR synon të mbështesë NVM-të në zhvillimin dhe zbatimin e bizneseve rrethore brenda një sistemi të integruar për zhvillimin lokal. Më konkretisht, ky projekt synon të përshpejtojë dhe mbështesë kapacitetin e NVM-ve në turizëm për të marrë zgjidhje të qëndrueshme, duke propozuar një fokus në mbetjet në sektorin e ushqimit, zgjidhjet pa plastike dhe rimendimin/ridizajnimin e paketimit dhe konsumin bashkëpunues.

DATA E FILLIMIT: 16 Shtator 2020

DATA E PËRFUNDIMIT: 15 Shtator 2023

KONSORCIUMI

Konsorciumi i projektit përbëhet nga **10 subjekte partnere:**

- **Odat Ekonomike:**
 1. Oda Ekonomike e Marches (Itali) – Udhëheqës
 2. Oda Ekonomike e Xanthi (Greqi)
 3. Forumi i Odave Ekonomike Adriatik dhe Jon (Itali)

- **Trajnim dhe Konsulencë:**

4. Projekti Arcadia (Itali)
5. Ecores (Belgjikë)
6. Qendra për Biznes dhe Inovacion (Maqedonia e Veriut)
7. Qendra për Inovacion Social Ltd. (Qipro)

- **Partnerët Akademik:**

8. Universiteti Politeknik i Marches (Itali)

- **Shoqatat e Biznesit:**

9. Organizata për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme "ODIMM" (Moldavi).

TAKIMI I PARË NDËRKOMBËTAR I PARTNERËVE

Më 15 dhe 16 Tetor 2020, në vend që të takoheshin ballë për ballë siç ishte planifikuar fillimisht, për shkak të rrethanave Covid-19, partnerët vendosën të tako-heshin online. Qëllimi ishte të përcaktoheshte korni-za, që Konsorciumi do të ndjekë gjatë periudhës së ardhshme, në mënyrë që qëllimet e projektit të arrihen. Më konkretisht, partnerët diskutuan mbi pro-jektin, objektivat e tij dhe paketat e punës, si dhe rolet dhe detyrimet e tyre.

ANKETIMI I NVM-ve

Si pjesë e paketës së parë të punës së projektit CEN TOUR, konsorciumi zhvilloi një anketë tek NVM-të në rajonet e zgjedhura të projektit. Objektivi i anketës ishte kuptimi më i mirë i hendekut aktual të aftësive me të cilat përballen NVM-të e turizmit kur dëshirojnë të kalojnë në ekonominë rrethore.

“Është e nevojshme të përshpejtojmë tranzicionin rrethor me trajnime dhe ta zhvillojmë atë në të gjithë zinxhirin e

furnizimit. Ne hartojmë dhe operojmë turne të cilat janë të pastra, në lidhje me mjedisin, dhe mjaftë të drejta në raport me komunitetet locale dhe udhëtarët poashtu. Megjithëse ne luajmë një pjesë të vogël në industrinë kombëtare dhe ndërkombëtare të udhëtimit, ne cdoherë tentojmë të implementojmë praktika të reja, të mira, të qëndrueshme për ta bërë botën një vend më të mirë për të jetuar dhe për të udhëtuar. Ne jemi të bindur se ndryshimi, për të ndodhur dhe për të marrë pjesë plotësisht, duhet të ndahet me të gjithë aktorët e industrisë. Shpesh është një përpjekje e tepërt për të ndryshuar të vetëm rutinën në të gjithë zinxhirin e furnizimit.”

“Unë kam vetëm njohuri themelore, nuk kam ndjekur ndonjë trajnim në ekonominë rrethore dhe nuk di si ta aplikoj atë në kompaninë time. Pas leximit të informacionit të përfshirë në këtë anketë, unë mund të mendoj për një përmirësim të lëvizshmërisë së qëndrueshme, por kërkon një investim që nuk mund ta arrij vetëm për momentin.”

Shumë NVM po përballen me disa sfida në tranzicionin drejt një ekonomie rrethore: pengesat financiare, mungesa e njohurive dhe rëndësia e arritjes së një ndryshimi sistemik për ta bërë tranzicionin sa më efektiv. Duke pasur parasysh këto, ofrimi i trajnimeve me një kurrikulë të përshatur do t'i përgjigjet disa prej këtyre sfidave.

PROGRAMI I TRAJNIMIT PËR NVM-të

Rezultatet e anketës do të kontribuojnë në zhvillimin e një programi për ndërtimin kapaciteteve dhe një program trajnimi për NVM-të e turizmit në mënyrë që t'u sigurojnë atyre aftësitë e nevojshme, njohuritë dhe mendësinë e duhur dhe burimet për të zhvilluar zgjidhje inovative drejt një ekonomie rrethore, duke rritur aftësinë e tyre për të rimenduar modelin e biznesit, produktet dhe shërbimet.

Kurrikula e trajnimit që del nga rezultatet është strukturuar në rreth 8 module, duke mbuluar temat e mëposhtme: hyrja e përgjithshme në ekonominë rrethore, tranzicioni i ekonomisë rrethore në organizatat e

turizmit, menaxhimi i energjisë dhe ujit në organizatat turistike, menaxhimi i mbetjeve ushqimore në organizatat e turizmit, zgjidhje pa plastikë dhe paketim i qëndrueshëm në organizatat e turizmit, konsumi bashkëpunues në sektorin e turizmit, çertifikim mjedisor, komunikim qarkor.

Për më tepër, rezultatet e anketës do t'i mundësojnë konsorciumit të formulojë përmbajtjen dhe aktivitetet e **Komunitetit të Praktikës** të ardhshëm të përqendruar në turizmin rrethor: ndarja e praktikave më të mira të suksesshme, organizimi i uebinarëve, kurse në internet dhe trajnimi kolektiv.

THIRRJE PËR PËRZGJEDHJE

Projekti së shpejti do të shpallë përmes një **Konference për shtyp**, si dhe faqes zyrtare të internetit dhe rrjeteve sociale një thirrje për përzgjedhje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të sektorit të turizmit. **68 përfituesit e përzgjedhur** (18 NVM në Itali, 14 në Spanjë, 12 në Moldavi, 12 në Maqedoninë e Veriut, 12 në Greqi), të financuar direkt nga projekti, do t'u jepet mundësia të forcojnë kapacitetet dhe aftësitë e tyre përmes programit të trajnimit të CENTOUR..

TURIZMI RRETHOR NË LAJME

Kjo pjesë ofron një pasqyrë të lajmeve më të fundit në turizmin rrethor:



- **World Economic Forum**
[How we can prioritize sustainability in rebuilding tourism](#)
- **The Fifth Estate**
[We have a chance to rebuild a thriving, circular tourism industry](#)
- **Hospitality Net**
[Global Tourism Plastics Initiative Welcomes 26 New Signatories](#)
- **UNCTAD**
[Life after lockdown: Rebuilding tourism globally, sustainably](#)

QËNDRO NË KONTAKT

Vizitoni uebfaqen oficiale www.circular tourism.eu, dhe na gjeni në rrjetet sociale:

Twitter: www.twitter.com/centourin

LinkedIn: www.linkedin.com/company/centour



CAMERA DI COMMERCIO DELLE MARCHE



CHAMBER OF COMMERCE AND INDUSTRY OF SANTHI



AIC



PROGETTO ARCADIA



EcoRes



Business Innovation Center



Center for Social Innovation



UNIVERSITÀ POLITECNICA DELLE MARCHE



ODIMM